



Rusia ka paraqitur planet për ndërtimin e një hoteli në hapësirë, i mbushur me shumë më tepër se pesë yje. Planet janë zbuluar në Moskë këtë javë nga “Orbital Technologies”, kompania ruse që kërkon të çojë turistët e pasur aty ku ata nuk kanë qenë kurrë më parë. Sipas të dhënave të para, qëndrimi për pesë ditë në këtë hotel astronomik do të jetë rreth 140.000 euro, por do të kushtojë rreth 300 mijë euro për të shkuar deri atje.

Deri tani rreth 500 njerëz kanë qenë në hapësirë. Përveç disa njerëzve super të pasur që kanë paguar për këtë privilegj, pjesa tjetër kanë qenë kozmonautë dhe astronautë të trajnuar. Shefi ekzekutiv i “Orbital Technologies”, Sergei Kostenko, tha se hoteli orbitë do të jetë shumë më i rehatshëm se Stacioni Ndërkombëtar Hapësinor. Me hapësirën për shtatë persona në katër kabina, vizitorët do të jenë në gjendje të shikojnë mrekullitë e hapësirës nëpërmjet disa dritareve shumë të mëdha. I quajtur Stacioni Komercial Hapësinor, ai do të ndërtohet 217 milje mbi tokë. Atje do të mund të shkohet nëpërmjet raketës ruse “Soyuz”./shqiperia/